



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
BASHKIA HIMARË  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. 3808/prot.  
2

Himarë, më 26.05. 2026

U R D H Ë R  
Nr. 285, datë 26.05.2026  
PËR

ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT ME OBJEKT  
“RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS MILTO KALLUSHI, LOTI II”

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 77 të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

1. Të kryhet prokurimi i fondit prej **104,166,667** (njqinde e kater milion e njqinde e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e shtatë lekë) **pa TVSH**, për objektin: “**Rikonstruksioni i rrugës Milto Kallushi, Loti II**”, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Himarë.

Në përputhje me kërkesën e mësipërme të drejtorisë së financës, planifikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve, lind nevoja për prokurimin e investimit, nga ky zë i regjistrit.

2. Kryerjen e këtij prokurimi sipas llojit të procedurës “Procedurë e hapur”, e parashikuar në nenin 42 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 47 të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Arsyet e përdorimit të procedurës së prokurimit:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 42 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në të cilën përcaktohet se : “Procedura e hapur është procedurë me një fazë, ku mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar. Në procedurën e hapur, autoriteti ose enti kontraktor shpall një njoftim, sipas përcaktimeve në nenin 56 të këtij ligji, i cili përmban një përshtkrim të objektit që do të prokurohet, në përputhje me parashikimet në rregullat e prokurimit publik” dhe pikës 1 të nenit 47 të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

3. Ngritjen e Njesisë së prokurimit me përbërjen e mëposhtme:
- **Z.Orest Vela**, Personi përgjegjës për prokurimin
  - **Z.Aristidh Goro**, Inxhinier ndërtimi
  - **Z. Uran Dulaj**, Financier

Njësia e prokurimit të hartojë dokumentet e tenderit dhe të gjithë dokumentacion përkatës në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

4. Ngarkohet njësia e prokurimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**VANGJEL TAVO**

**ME URDHËR DHE DELEGIM**  
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**  
**PERVIN GJIKURIA**

